



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1994/4 prot.

Datë 25.06.2026

V E N D I M

Nr. 869/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro

Nënkryetar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersini

Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.06.2026 shqyrtoi kërkesën me:

Objekt:

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës me nr. 1994/2026 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6859 për procedurën e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-89611-06-10-2026, me objekt: “*Sisteme elektronike*”, me fond limit 63,031,119.00 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 13-07-2026 nga autoriteti kontraktor Illyrian Guard SH.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK, me NUIS L92230027U dhe adresë: Rruga e "Kavajes", Kompleksi "Square 21", sh.2, k.9 me numer pasurie 1/710+2-30, Tirane.

Autoriteti Kontraktor:

Illyrian Guard SH.A, me adresë: Rruga “Ibrahim Rugova”, Tiranë 1016

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.500/2020, datë 05.11.2020 “Rregullore për marrjen e masave organizative për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi kërkesën e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11-06-2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-89611-06-10-2026, me objekt: “Sisteme elektronike”, me fond limit 63,031,119.00 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 13-07-2026 nga autoriteti kontraktor Illyrian Guard SH.A.

II.2. Në datën 22.06.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1994/2026 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6859, datë 22.06.2026 e operatorit tuaj ekonomik “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të

procedurës), ankesën e plotë me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.4. Në datën 24.06.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1994/1 prot., shkresa e operatorit ekonomik ankimues “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK me nr.88 prot., datë 24.06.2026 me objekt: *“Tërheqje ng ankimi sipas nenit 117 të LPP”*. Me anë të kësaj shkrese operatori ekonomik ankimues kërkon të tërhiqet nga ankesa e tij me nr. Prot., 1994/2026 datë 22.06.2026 për procedurën e prokurimit *“E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”*, me Nr. REF-89611-06-10-2026, me objekt: *“Sisteme elektronike”*, me fond limit 63,031,119.00 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 13-07-2026 nga autoriteti kontraktor Illyrian Guard SH.A, pasi: *“[...] pas sqarimeve të dhëna nga autoriteti kontraktor lidhur me lejimin e mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera për përmbushjen e kriterit të stafit inxhinierik, nuk ka më interes për vijimin e ankimit të paraqitur”*.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK me nr.88 prot., datë 24.06.2026 me objekt: *“Tërheqje ng ankimi sipas nenit 117 të LPP”*, për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit *“E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”*, me Nr. REF-89611-06-10-2026, me objekt: *“Sisteme elektronike”*, me fond limit 63,031,119.00 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 13-07-2026 nga autoriteti kontraktor Illyrian Guard SH.A, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

“1. Ankimesi ka të drejtë që të tërheqë ankesën e depozituar në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e saj nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Tërheqja e ankesës konsiderohet si mospranim ankese dhe ankimesit nuk i kthehet tarifa e ankesës.

2. Në rast të tërheqjes së ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik ndërpret shqyrtimin e saj menjëherë dhe merr vendim për mbylljen e çështjes.”

III.1.2. Bazuar në parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij, që në çdo kohë përpara përfundimit të afatit për shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në ankimin e tij. Në këto kushte, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik ankimues “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK për heqje

dorë nga ankesa e bërë, në zbatim të pikës 2, të nenit 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të ndërpresë menjëherë shqyrtimin e ankesës me nr. 1994/2026 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2026/66859, datë 22.06.2026 për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, si dhe do të mbyllë çështjen administrative.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 117 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të përfundojë procedimin administrativ për ankesën e operatorit ekonomik “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-89611-06-10-2026, me objekt: “Sisteme elektronike”, me fond limit 63,031,119.00 lekë pa tvsh, parashikuar për tu zhvilluar në datën 13-07-2026 nga autoriteti kontraktor Illyrian Guard SH.A.
2. Lejohet autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së mësipërme të prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

